



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

## PROGRAM ORIENTUES PËR PORTALIN E

“SHËRBIMIT PSIKO – SOCIAL”, 2020

### PUNONJËSI SOCIAL

#### I. HYRJE

Programi orientues për portalin e “Shërbimit psiko - social” është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin në shërbimin psiko – social në shkollë. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të psikologut shkollor dhe punonjësit social dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- b) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- c) Përmbajtja shkencore sipas formimeve përkatëse të psikologut shkollor dhe punonjësit social.

#### II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për portalin e “Shërbimit psiko – social” është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të kandidatëve. Programi synon:

---

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- Rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformave arsimore.
- Rritjen e kompetencave profesionale për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit të shërbimit psiko - social.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së psikologëve shkollorë dhe punonjësve social për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive të profesionit, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së psikologëve shkollorë dhe punonjësve social për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet komunikimit dhe punës me nxënësit dhe stafin e shkollës.

### III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për portalin e “Shërbimit psiko – social” është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë psikologu shkollor ose punonjësi social. Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e fushë përkatëse, do ta ndihmojnë kandidatin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojë kandidati, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

## FUSHA “DOKUMENTE ZYRTARE”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p><b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”</b></p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>kandidati:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar;</li> <li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për punën e shërbimit psiko - social;</li> <li>- zbaton udhëzuesit për funksionimin e institucionit arsimor;</li> <li>- respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- respekton detyrat dhe të drejtat e prindërve;</li> <li>- zotëron njohuri për funksionimin ligjor të institucionit arsimor;</li> <li>- zbaton ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;</li> <li>- zotëron njohuri për etikën profesionale;</li> <li>- zbaton strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar;</li> <li>- zbaton strategjinë për gjithëpërfshirjen,</li> <li>- zbaton strategjinë për arsimimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë;</li> <li>- njeh procedurat e menaxhimit të rastit;</li> <li>- zbaton strategjinë për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm;</li> <li>- njeh profilin e mësuesit gjithëpërfshirës;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>- Rregullore për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë, Tiranë 2020.</li> <li>- Urdhër nr. 150, datë 3.4.2018 ‘Për një ndryshim në Urdhrin nr. 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”.</li> <li>- Urdhër nr. 593, datë 31.12.2019 “Për Disa Ndryshime në Urdhrin 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”,i ndryshuar.</li> <li>- Vlerësimi i Jashtëm dhe i Brendshëm i Shkollës.</li> <li>- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</li> <li>- Ligj nr.10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.</li> <li>- Vendim Nr. 483, datë 29.6.2016. “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, 2016–2020”.</li> <li>- Vendimi Nr. 1072, datë 23.12.2015. Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020.</li> <li>- Vendim Nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për</li> </ul>

	<p>zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimi Nr 930, datë 18.11.2015. Për miratimin e strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit.</li> <li>- Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.</li> <li>- Vendimi Nr. 353, datë 12.6.2018. Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial Për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive Administrative.</li> <li>- Udhëzimi nr. 25, datë 2.8.2013. Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve.</li> <li>- Udhëzimi nr. 25, datë 25.7.2018. Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor.</li> <li>- Urdhër 195. 25.04.2016. Miratimin e dokumentit "Edukimi dhe formimi Profili i mësuesit gjithëpërfshirës".</li> </ul>
--	--

## FUSHA “PUNONJËSI SOCIAL”

<b>Kompetenca 1</b>	
<b>“Demostron sjellje profesionale dhe etike”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Kandidati:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton standardet etike;</li> <li>- përdor reflektim dhe vetë-rregullim për të menaxhuar vlerat personale dhe për të ruajtur profesionalizmin në situata praktike;</li> <li>- demonstron sjellje profesionale; pamja e jashtme; komunikimi verbal, joverbal dhe ai i shkruar;</li> <li>- përdor teknologjinë në mënyrë etike dhe të përshtatshme për të lehtësuar rezultatet e praktikës;</li> <li>- përdor supervizimin dhe konsultimin për të udhëhequr gjykimin dhe sjelljen profesionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- “Inspektimi dhe Vetëvlerësimi i Shërbimit Psikologjik në Shkollë”.</li> <li>- Gjermani, E. (2010). Modele dhe shprehje në praktikën e punës sociale. Tiranë: Mediaprint. Fq. 1-230.</li> </ul>
<b>Kompetenca II</b>	
<b>“Angazhohet dhe vlerëson punën me individë, familje, grupe, organizata dhe komunitete”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Kandidati:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton njohurit për sjelljen njerëzore dhe mjedisin shoqëror dhe teoritë e tjera multidisiplinare;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- “Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare”.</li> <li>- Ministria e Arsimit Sportit, Save the Children. (2014). <i>Standardet e shkollës si qendër komunitare</i>.</li> <li>- Save the Children. (2017a). <i>Udhëzues praktik për hartimin dhe zbatimin e planit individual edukativ (PEI)</i>.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor empatinë, reflektimin dhe aftësitë ndërpersonale për të përfshirë në mënyrë efektive klientë të ndryshëm</li> <li>- mbledh dhe organizon të dhënat dhe përdorë mendimin kritik për të interpretuar informacionin nga klientët</li> <li>- zhvillon qëllime të ndërhyrjes të bazuara në vlerësimin kritik të pikave të forta, nevojave dhe sfidave të klientëve</li> <li>- zgjedh strategjitë e duhura të ndërhyrjes bazuar në vlerësimin, në kërkimet mbi njohuritë vlerat dhe preferencat e klientëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Arsimit dhe Sportit, IZHA, ASSA, UNICEF. (2016). <i>Manual mbi Sistemin e Parandalimit të Hershëm të Braktisjes Shkollore Trajnimi i institucioneve arsimore të arsimit bazë.</i></li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>“Ndërhyn dhe menaxhon punën me individin, familjen, grupet, organizatat dhe komunitetet”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Kandidati:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjedh dhe zbaton në mënyrë kritike ndërhyrjet për të arritur qëllimet e praktikës dhe për të rritur kapacitetet e klientëve;</li> <li>- përdor bashkëpunim ndër-profesional për të arritur rezultate të dobishme të praktikës;</li> <li>- negocion, ndërmjetëson dhe advokon me dhe në emër të klientëve dhe grupeve të ndryshme;</li> <li>- zgjedh dhe përdor metoda të përshtatshme për vlerësimin e rezultateve;</li> <li>- analizon, monitoron dhe vlerëson në mënyrë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Terre des Hommes. (2020). <i>Manuali i punës për punonjësit e njësisë së shërbimit psiko-social në shkolla.</i></li> <li>- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, IZHA, UNICEF. (2019). <i>“Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive në Shkollë si Mënyrë Për Parandalimin e Dhunë”.</i></li> </ul>

<p>kritike proceset dhe rezultatet e ndërhyrjes dhe programit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbatojn gjetjet e vlerësimit për të përmirësuar efektivitetin e praktikës në nivelin mikro, mezzo dhe makro.</li> </ul>	
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca IV</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Aplikon në praktikë teoritë dhe modelet kryesore të punës sociale, lidhur me praktikën e punës sociale në shkolla”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Kandidati:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formulon trajtimin e një rasti individual në shkollë</li> <li>- dizenjon një vlerësim të thjeshtë të shkollës si organizatë</li> <li>- analizon një problem të komunitetit shkollor dhe rekomandon ndërhyrje</li> <li>-</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tahsini, I. (2020). Përzgjedhje leksionesh të lëndës ‘Puna Sociale në Shkolla’.</li> <li>- Bashkimi European &amp; Këshilli i Europës. 2018. <i>“Udhërrëfyes për politika që synojnë parandalimin e bullizmit në sistemin arsimor në Shqipëri”</i>.</li> <li>-</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca V</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Kupton sesi diversiteti dhe ndryshimet në praktikë karakterizojnë dhe formojnë përvojën njerëzore dhe janë thelbësore në formimin e identitetit.”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Kandidati:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Psikologjisë. (2019). <i>Udhëzuesi Për ndërhyrjen e parë psikologjike në kontekstin shkollor.</i></li> <li>- World Vision. (2014). Jam mes jush i</li> </ul>

- aplikon dhe komunikon rëndësinë e diversitetit dhe ndryshimit në formimin e përvojave të jetës në praktikë në nivelet mikro, mezzo dhe makro;
- prezanton veten si nxënës dhe angazhon klientët si ekspertë të përvojave të tyre;
- aplikon vetë-vetëdijen dhe vetë-rregullimin për të menaxhuar ndikimin e paragjytimeve dhe vlerave personale në punën me klientë të ndryshëm.

ndryshëm, i ngjashëm, i barabartë.